

## Formular për SYLLABUS të Lëndës

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti Juridik</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>E Drejta e Detyrimeve</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Bachelor</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Obligative</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>III</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>3+1</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>6</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>/Prishtine</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof.Dr. Nerxhivane Dauti Mr.sc. Sefadin Blakaj</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<b>nerxhivane.dauti@uni-pr.edu sefadin.blakaj@uni-pr.edu</b>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>Në shoqëri bashkëkohore të karakterizuar nga sistemi i "ndërmarrjes së lirë" dhe nocionet e lirisë individuale, "kontrata" është një nga mjetet kryesore me të cilat individët privat dhe firmat afariste kryejnë punët e tyre. Lënda e drejta e detyrimeve zhvillon më tej njohurinë e kandidatëve në fushën e Detyrimeve dhe parashtron pyetjet si përse premtimet janë zbatuar si kontrata, cilat premtime zbatohen, dhe se si ato zbatohen në marrëdhëniet e përditshme tregtare. Lënda vë theksin mbi analizën e ngushtë dhe kritike të detyrimeve të ligjit vendor si ajo ndikon në ditë për ditë të biznesit kontraktuese. Lënda shqyrton çështjet kryesore ligjore që prekin marrëveshjet e zbatueshme. Këto çështje përfshijnë pyetjet për atë se kur një kontratë të bëhet e detyrueshme, çfarë personash fitojnë të drejtat sipas një kontrate, kushtet nën të cilat kërkohet apo nuk kërkohet garancia për performancë, çka përbën shkelje të kontratës, dhe mjetet juridike në dispozicion në rast të shkeljes së kontratës. Do të ketë diskutime për problemet e mundshme në kontrata, dhe zgjedhjen e teknikave të kontratës për të shmangur rreziqet e procesit gjyqësor në mjedise të pasigurta ligjore, siç janë përdorimi i dëmeve të likuiduara dhe klauzola e dorëzanisë. Gjatë tërë kohëzgjatjes së lëndës, do t'i kushtohet kujdes problemeve të përgjithshme të interpretimit të gjuhës së kontratës, rolit të kontratave në një shoqëri tregu, konflikt në mes të nevojës komerciale për siguri dhe kërkesave të drejtësisë individuale.</p>

<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<p>Kjo lëndë ka për synim njoftimin e studentëve me esencën dhe bazat e së drejtës së detyrimeve dhe krijimin e një baze e cila do të plotësohet nga lëndët tjera nga lëmia civile që studentët do ti dëgjojnë gjatë studimit të tyre. Kjo lëndë ka disa qëllime kryesore, edhe atë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Studentët të jenë të njoftuar lidhur me konceptet dhe përmbajtjen e të Drejtës së detyrimeve, si e drejte pozitive dhe e zbatueshme.</li> <li>-Të inicihet mendimi kritik në klasë.</li> <li>-Të aftësohen studentët që informatat e fituara ti shfrytëzojnë për të dhënë vlerësime dhe për të konstruktuar argumente.</li> <li>-Të zhvillohen aftësitë komunikuese të studentëve.</li> <li>-Të dijë t’i interpretoj dhe aplikoj dispozitat juridike nga kjo fushë;</li> <li>-Të jetë i gatshëm për përgatitjen e programeve, me qëllim të interpretimit të normave juridike të detyrimeve;</li> </ul>
---------------------------	---

<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p>Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kuptojnë dhe sqarojnë konceptet dhe përmbajtjen e të Drejtës së detyrimeve, si e drejtë pozitive dhe e zbatueshme.</li> <li>- Të dijë t’i interpretoj dhe zbatoj dispozitat juridike nga fusha e të drejtës kontraktuese;</li> <li>- Të kuptoj ndikimin e shprehjeve dhe terminologjisë juridike të përdorura në hartimin e kontratave;</li> <li>- Të hartojnë dhe interpretojnë kontratat, gjegjësisht dispozitat kontraktuese;</li> <li>- Të dijë t’i interpretoj dhe zbatoj dispozitat juridike nga fushat dhe institutet tjera të së drejtës së detyrimeve, si shkaktimin dhe shpërblimin e dëmit, pasurimin e pabazë, gjerimin e punëve të huaja pa porosi dhe shprehjen e njëanshme të vullnetit;</li> <li>- Të përdorë metodat më adekuate më qëllim të ndërtimit të një sistemi adekuat të të drejtës së detyrimeve;</li> </ul>
---	---

<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënies të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	3	1/15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	1	1/15	15
Punë praktike	1	1/15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	1/15	15
Ushtrime në teren	1	1/15	15

Kollokfiume,seminare	2	2/5	10
Detyra të shtëpisë	2	1/5	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	1/15	15
Përgaditja përfundimtare për provim	2	1/5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	5	1/1	5
Projektet,prezentimet ,etj	10	1/1	10
<b>Totali</b>	<b>5 ECTS</b>	<b>Total</b>	<b>165</b>

<p><b>Metodologjia e mësimdhënies:</b></p>	<p><b>Metoda tradicionale e ligjërimit:</b> Disa prej mënyrave më të mira për dhënie e mësimi për ligjin mund të arrihen përmes metodës klasike të ligjërimit. Për këtë lëndë është parapa të përdor një numër të kufizuar të ligjëratave me grupe të mëdha për të siguruar që kandidatët të kenë një bazë të fortë në doktrinën ligjore tradicionale të së drejtës së detyrimeve. Metoda e praktikës dhe simulimit kanë për qëllim që të plotësojnë njohuritë dhe të kuptuarit e doktrinës së paraqitur në sallën e ligjërimit duke kuptuar implikimin e saj dhe përdorimin e saj në aktivitetet ditore të biznesit.</p> <p><b>Seminaret dhe seancat praktike:</b> Metodologjia e mësimdhënies konsiston në kombinimin e punës teorike dhe praktike. Një tipar dallues i përbashkët për të gjithë seancat praktike, është numri relativisht i vogël i studentëve të cilët zakonisht regjistrohen në seancat e tilla. Pjesa më e madhe e këtyre seancave praktike kërkojnë që studentët të shkruajnë, draftojnë apo përgatisin një sasi të konsiderueshme të formave të kontratave. Pjesa më e madhe e tyre do të jenë të natyrës intensive praktike, duke simuluar probleme nga përditshmëria jonë; të tjerat janë të organizuara sipas temave, duke përfshirë studimin nga afër të temave me interes bashkëkohor.</p>
<p><b>Metodat e vlerësimit:</b></p>	<p>Edhe pse kërkohet provimi përfundimtar, nota përfundimtare e studentit për këtë lëndë më-simore bazohet në punën e përgjithshme gjatë gjithë semestrit Për vlerësimin e studentëve nga lënda e “kontratave komerciale”, mësimdhënësi do të ketë në konsideratë këto kritere:</p> <p>-Vijimi i rregullt në ligjëratat .....10%  -Kollokfiumi .....30%  -Provimi final .....60%</p>

<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	1. Dr. Sc. Nerxhivane Dauti, E drejta e detyrimeve, Prishtinë, 2012, 2. Ligji nr. 04/L-077 për mardhëniet e detyrimeve, 3. Nerxhivande Dauti & ; Ruzhdi Berisha & ; Adem Vokshi & ; Abdulla Aliu & Sefadin Blakaj, Komentar Ligji për Mardhëniet e Detyrimeve, Libri I dhe II Prishtinë, 2013
<b>Literatura shtesë:</b>	1. R.G. Lawson, Susan Sigleton, Commercial Contracts- A practical guite to standart terms. Tottel Publishing, 2016 2. Dr. Mariana Semini, E drejta e detyrimeve, Tiranë, 2003; 3. Sefadin Blakaj, Draft Common Frame of Reference (DCFR) in European Contract Law-with a focus on pre-contractual duties (Graz: University of Graz, 2008).
<b>Plani i dizajnuar i mësimimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	-Sistematizimi i lëndës -Karakteristikat e detyrimeve; -Llojet e detyrimeve; -Burimet e detyrimeve;
<b>Java e dytë:</b>	-Kontratat e detyrimeve; -Kushtet për lidhjen e kontratës; -Negociatat, oferta; -Klasifikimi i kontratave; -Interpretimi i kontratave; -Parimet e kontratave.
<b>Java e tretë:</b>	-Shkaktimi i dëmit; -Llojet e dëmit; -Shkaqet e shkaktimit të dëmit; -Përgjegjësia deliktore civile dhe llojet
<b>Java e katërt:</b>	-Përjashtimi i veprimit antijuridik; -Fuqia madhore; -Dëmi i shkaktuar nga personi i tretë; -Rasti.
<b>Java e pestë:</b>	-Përgjegjësia subjektive; -Përgjegjësia objektive; -Përgjegjësia për të tjerët; -Baza e përgjegjësisë.

<b>Java e gjashtë:</b>	-Shpërblimi i dëmit; -Shpërblimi i dëmit material; -Kushtet e shpërblimit; -Kriteret e shpërblimit; -Shpërblimi i dëmit jomaterial; -Satisfaksioni
<b>Java e shtatë:</b>	-Do të bëhet vlerëimi i parë intermediar përmes kolokiumit, i cili do të përmbajë 15 pyetje që kryesisht do t'i referohen ligjëratave të mbajtura deri në javën e shtatë
<b>Java e tetë:</b>	-Pasurimi pabazë juridike; -Kushtet e pasurimit; -Rastet e pasurimit; -Efektet e pasurimit; -Papia e pasurimit të pabazë.
<b>Java e nëntë:</b>	-Gjerimi i punëve të huaja pa pagesë; -Kushtet e gjerimit; -Llojet e gjerimit; -Natyra juridike.
<b>Java e dhjetë:</b>	-Premtimi publik i shpërblimit; -Kushtet e shpërblimit; -Efektet;
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Letrat me vlerë; -Llojet e letrave me vlerë; -Efektet. -Letrat e legjitimacionit; -Shenjat e legjitimacionit;
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	- Efektet e detyrimeve; -Vonesa e debitorit dhe e kreditorit -E drejta e ndaljes;
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	-Papia pauliana; -Efektet juridike të padisë pauliana; -Afati i paraqitjes së padisë
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	-Cedimi; -Llojet, lënda, kushtet e cedimit; -Bartja e kontratës; -Ndërrimi i debitorit; -Dërgimi (Asignacioni);
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	-Shuarja e detyrimeve; -Llojet e shuarjes; -Mënyrat vullnetare; -Mënyrat kundërvullnetare; -Parashkrimi.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Gjate procesit mësimor dhe atij te vlerësimit te studentëve përfshirë edhe kontaktet tjera me student qe ndërlihen me raportet studimore, mesimdhënesi duhet te ruaj integritetin e tij akademik dhe te tregoj vlera te larta morale dhe njerëzore si dhe te jete i paanshëm dhe te jete ne gjendje qe te përballet me çdo sfide ne këtë drejtim nga çdo ndikim apo presion qe mund t'i behet nga te tjerët. Studentet janë te obliguar t'i përmbahen rregullave te mirësjelljes si gjate ligjëratave, ushtrimeve dhe provimit, në të kundërtën mund të rrezikojnë të jenë palë në procedurat disiplinore sipas rregullave të Fakultetit Juridik dhe rregullave të Universitetit të Prishtinës.

Plagjiatura paraqet shkelje të rëndë, andaj konstatimi i së njëjtës paraqet bazë të mjaftueshme nga përjashtimi nga lënda në fjalë!